



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “**VISI-JONI**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L31710003T**, me seli: *Tiranë, Tiranë, TIRANË, Rruga “Don Bosko”, Pallati Shekulli, hyrja 1, apartamenti 22.*

Procedura e prokurimit: “**E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime**”, *prokurim elektronik – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.*

Numri i referencës së procedurës: **REF-00079-04-04-2024**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “*Shërbim transporti materialesh sipas marrëveshjes me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në Bashkinë Mat*”, me fond limit në vlerën: **1 640 000** (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë) **lekë pa TVSH**, nga grand i bashkisë në vlerën: 833 333.33 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, dhe nga të ardhurat: 806 666.67 (tetëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, me afat realizimi të marrëveshjes kuadër: **12** (dymbëdhjetë) **muaj**.

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 18, datë 08 Prill 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “**SHEHU**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J66702707S**
Vlera: **1 500 000** (një milion e pesëqind mijë) **lekë pa TVSH.**

2. Operatori Ekonomik: “**VISI-JONI**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L31710003T**
Vlera: **1 592 000** (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) **lekë pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “SHEHU” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J66702707S

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “SHEHU” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk janë përmbushur përcaktimet e pikës 1 gërma “a” dhe “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

➤ Këto kushte nuk përmbushen nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur konstatohet se:

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është paraqitur sipas formatit të miratuar të shtojcës 9 në DST për shërbime.
- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor/ administratori i shoqërisë, por nga ortaku i vetëm i shoqërisë.
- Gjithashtu, në seksionin “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit - A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk është deklaruar emri i përfaqësuesit ligjor/ administratorit të shoqërisë se nuk është i dënuar/ ose ka qënë i dënuar për veprat penale të përcaktuara në nenin 76 të LPP-së.
- Formulari i Sigurimit të Ofertës me Nr.serial:240601366, datë 15.04.2024, nuk është lëshuar për procedurën objekt prokurimi me Nr. REF-00079-04-04-2024, por për procedurën e mëparshme të anuluar me Nr. REF-94635-02-06-2024

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “VISI-JONI” Sh.p.k., me seli: Tiranë, Tiranë, TIRANË, Rruga “Don Bosko”, Pallati Shekulli, hyrja 1, apartamenti 22, me numër Nipt-i: L31710003T, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **1 592 000** (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Titullari i Autoritetit Kontraktor